

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar :

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi limit pa TVSH Në lekë	Periudha në muaj	Nr. Rojeve
1.	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të ambienteve të DRFSDKSH –së Tiranë për vitin 2017.	2,590,147.5	10 muaj	5

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimit që kërkohet :

1- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë do të përfshijë sigurimin e ambienteve ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i DRFSDKSH-së Tiranë dhe të ambienteve rrethuese, nga dëmtimet, vjedhjet e mundshme si dhe sigurimin e punës normale të administratës dhe të punonjësve të saj.

2- Kryerja e shërbimit të jetë 24 orëshe (nga ora 00^{oo} deri në ora 24 ^{oo}), çdo ditë kalendarike me një vendroje.

3- Punonjësit e shërbimit duhet :

- Të jenë të pajisur me uniformë me siglën dalluese të shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe me dokument identifikimi personal për çdo punonjës shërbimi.
- Të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim për të bërë të mundur parandalimin dhe ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dëm të objektit që ka nën ruajtje .
- Gjatë turneve të dyta dhe të treta të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit.
- Të sigurojë vendparkimin e ndodhur në DRFSDKSH-në Tiranë, në të cilën do të parkohen dhe të ruhen nga shoqëria automjetet e institucionit dhe të punonjësve të DRFSDKSH-së Tiranë, sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Para marrjes së shërbimit, të kontrollojë objektin në prezencë të punonjësit dorëzues dhe për çrregullimet e konstatuara të njoftojë përgjegjësën e punonjësve si dhe të mbajë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si; rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjen ndaj zjarrit. Për çdo parregullsi të informojë me shkrim përgjegjësën e rojeve dhe ate të objektit.
- Në rast zjarri të marri masa për shuarjen e tij dhe menjëherë të njoftojë zjarrëfikset.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, të bëhet bllokimi i mjedisit si dhe i autorit dhe të njoftojë menjëherë organet kopetente.

- Për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min para orarit. Ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar.
- Ndalohet futja dhe qëndrimi në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rasteve për zbatimin e rregullores.
- Gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me punonjësit, si dhe gjatë kohës së shërbimit i ndalohet përdorimi i pijeve alkolike.

Në vënd roje duhet të jenë këto dokumenta:

- Rregullorja e brendshme
 - Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit.
 - Grafiku i shërbimit.
 - Mjete ndriçimi në rast mungese energjie elektrike.
 - Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.
 - Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në hapësirën e planifikuar për parkingun në territorin e objektit.
- Shoqëria duhet të marrë përsipër zhdëmtimin 100% të dëmeve që vijnë për shkak të mos kryerjes si duhet të shërbimit, nga punonjësit e shoqërisë.



SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

1-Ofrimi i shërbimeve të ruajtjes dhe garantimi i sigurisë së ambienteve ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti i DRFSDKSH-se Tirane dhe të ambienteve rrethuese, ku parkohen automjetet e institucionit dhe të punonjësve.

2- Afatet e ekzekutimit:

Afati i ekzekutimit do të fillojë nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2017

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

1. Objekti dhe qellimi i shërbimeve: “Ruajtja e sigurisë fizike të godines”

Ofrimi i shërbimit të rojeve civile për të garantuar sigurinë fizike për godinen ku zhvillojnë aktivitetin e tyre institucioni i DRFSDKSH-së Tiranë

2. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objektit brenda dhe përreth tij.

3. Objektivat: Të ruaj me përkushtim objektin që i është besuar, të ruaj rendin në to, si dhe të sigurojë jetën e personelit.

4. Detyrat: Roja ka për detyrë:

-Të mos lejojë futjen e personave pa autorizim.

-Për persona që vijnë për probleme pune, duhet të njoftoj më parë kërkuesin dhe me lejen e tij e shoqeron tek personi i kërkuar.

-Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorezuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënime të përkatëse në librin e shërbimit.

-Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlikues, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim përgjegjës të rojeve dhe atë të objektit

-Në rast zjarri mer masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset.

-Të kërkojë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.

-Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente.

-Roja i objektit për kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me policinë e rendit.

-Roja për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min. para. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjës të shërbimit.

-Roja gjatë kohës së shërbimit duhet të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.

-Rojës, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkoolike, të flejë, të bisedojë me njerëz të jashtëm.

-Roja duhet të zbatojë vetëm urdhërat e përgjegjës të rojeve dhe drejtorit përkatës.

-Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a- Rregullorja e brendshme

b- Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit.

c- Grafiku i shërbimit.

d- Inventari i materialeve që ndodhen në objekt.

e- Mjete ndriçimi në rast mungese energjije elektrike.

f- Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

g- Skemën e njoftimi në rast sulmi ose zjarri në objekt.

h- Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

-Roja për probleme urgjente të shërbimit përdor mjetet e ndërlidhjes ne përdorim te shoqerise.

-Ndalohet ndërrimi i grafikut të shërbimit pa miratimin e përgjegjësit të rojeve.

.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Drejtoria Rajonale e FSDKSH-së Tiranë

Public Health Sector

